
***Qershor 2025***

Preventivues
**"SELAS" sh.p.k**
*Ing. Vladimir Agalliu*

**“SELAS” sh.p.k**
Projekt – Menaxhim - Konsulta
*Adresa : Rruga Vaso Pasha, Nr.7/1* *Tel / Email: + 355 68 20 95 150 , selasltd@hotmail.com*
*Tiranë-Albania*

# RELACION TEKNIK

## PËR REHABILITIMIN (E PJESSHËM) TË KANALIT USHQYES TË REZERVUARIT TË MBOLANIT, BASHKIA BERAT



*Fig.1.* Pamje nga Diga e Rezervuarit të Mbolanit

*Tirane, Qershor 2025*

*Adresa : Rruga Vaso Pasha, Nr.7/1* *Tel / Email: + 355 68 20 95 150 , selasltd@hotmail.com*
*Tiranë-Albania*

# PËRMBAJTJA

1. **Disa të Dhëna për Detyrën e Projektimit dhe Detaje të saj**

2. **Relacioni Teknik**

2.1. Disa të dhëna të përgjithshme për veprën

2.2. Disa të dhëna për rezervuarin e Mbolanit dhe gjendjen aktuale të kanaleve ujitës e në mënyrë të veçantë e kanalit ushqyes të rezervuarit.

2.3. Kushtet e përgjithshme klimaterike dhe Hidrologjia e zonës

2.4. Regjimi i rreshjeve

2.5. Kushtet gjeologo – inxhinerike te zones dhe të diges e të nenobjekteve qe lidhen me te

3. **Preventivi Përmbledhës**

4. **Disa Analiza të Cmimeve**

5. **Koreografia e Përgjithshme e Zonës**

Projekti për objektin : **“Rehabilitimi (i Pjesshëm) i Kanalit Ushqyes të Rezervuarit të Mbolanit”, Bashkia Berat** synon hartimin e projekteve të nevojshme për rikonstruksionin (e pjesshëm) të kanalit ushqyes të rezervuarit të Mbolanit, me të cilin do të bëhet e mundur që në rezervuarin e Mbolanit të grumbullohet një sasi më e konsiderueshme uji, në mënyrë që nëpermjet mbushjes së këtij rezervuari te mundsohet ujitja e sipërfaqes së tokave që janë planifikuar të ujiten nga ky rezervuar (me aftesi ujitëse e projektuar të rezervuarit rreth 90 ha ose 900 dynym tokë).

Relacioni teknik dhe projekti i zbatimit të këtij objektit: “Rehabilitimi (i Pjesshëm) i Kanalit Ushqyes të Rezervuarit të Mbolanit”, në njësinë administrative Sinjë, hartohet duke u bazuar kryesisht, si më poshtë :

a. Është bazuar në njohjen dhe detajimin e Detyrës së Projektimit, që është përgatitur në dt. ***___/04/2025,*** midis specialistëve të Bashkisë Berat dhe specialistëve të firmës projektuese “Selas” sh.p.k., Tiranë.
b. Është bazuar në njohjen dhe në detajimin e kërkesave baze të përgatitura për firmën projektuese “Selas” sh.p.k në bashkepunim me drejtues të Sh.P.U-së (Shoqatës së Përdorimit të Ujit), përfaqësues të fshatit e te Pushtetit lokal të njësisë administrative Sinjë, të cilat janë miratuar nga drejtoritë përkatëse në Bashkinë e Beratit.

Në këto materiale kryesore përcaktohen edhe drejtimet dhe kërkesat kryesore të punës projektuese për rehablitimin e kësaj vepre, ku midis të tjerash kërkohet:

- Te bëhen vlerësimet dhe të hartohen projektet e rehabilitimit e kanalit ushqyes të rezervuarit të Mbolanit, me të cilin do të mundësohet mbushja me ujë e me rrjedhje të lirë e rezervuarit ujitës me kapacitet ujmbajtëse aktuale që ai mundëson. *(Shih më poshtë disa të dhëna fizike e hidroteknike të rezervuarit të Mbolanit, si dhe aftësinë ujitëse të tij).*
- Shtrirja e punimeve rehabilituese për këtë kanal ushqyes do të behet në funksion të kushteve konkrete të gjendjes së kanalit si dhe në funksion të fondit monetar të parashikuar për këtë objekt.
- Në projekt duhet të mbahen parasysh në mënyrë të veçantë kriteret bazë të trajtimit të këtyre veprave, duke mbajtur në konsideratë kërkesat imediate dhe ato në perspektivë të

*Adresa : Rruga Vaso Pasha, Nr.7/1* *Tel / Email: + 355 68 20 95 150 , selasltd@hotmail.com*
*Tiranë-Albania*

komunitetit, ku përgjithësisht adresohen e vihen në dukje punimet kryesore qe duhen parashikuar e duhen përfshirë në preventivin e këtyre punimeve.

Ndër këto punime, mund të përmenden:

- Punime dheu kryesisht për gërmimin dhe riseksionimi e kanalit,
- Punime për veshjen me beton të seksionit tërthor të kanalit, në një gjatesi të caktuar (që papaprakisht mund te arrije ne rreth 300 ml)
- Punime për riparimin ose rindërtimin e disa vprave te artit per gjatë kanalit, si ura tombino, mure mbajtës etj.

Mbi keto baza firma projektuese ka nisur punën per hartimin e projektit të zbatimit të kësaj vepre, duke kryer vrojtimet e nevojshme e duke bërë njohjen më nga afër me zonën në fjalë, si dhe duke bërë azhornimet, piketimet dhe të gjitha matjet e nevojshme topografike për rrjetin ujites të kësaj vepre.

Gjithashtu, projekti ka kryer studimet e nevojshme inxhinierike perfshi edhe ato hidrologjike apo hidrogjeologjike etj. Duke vleresuar veprat ekzistuese të ndërtuara në këtë zone si dhe duke tërhequr mendime për mënyrën e funksionimit të tyre, nga mjaft specialistë që janë marrë me projektimin e me ndërtimin e kësaj vepre apo dhe me ata që aktualisht e për një kohe të gjatë merren me shfrytëzimin e këtyre veprave.

Se fundi, në këtë fazë të projektit është bërë një vlerësim paraprak i kostos së punimeve që do të kryhen sipas këtij projekti dhe është arritur dhe janë dhënë disa konkluzione të nevojshme në lidhje me rehabilitimin dhe shfrytëzimin e kësaj vepre.

Në menyre më të detajuar për disa nga problemet teknike dhe për punimet rehabilituese që janë parashikuar të kryhen sipas këtij relacioni teknik në këtë kanal ushqyes, apo në nyje të veçanta të tij mund te thuhet:

*Adresa : Rruga Vaso Pasha, Nr.7/1* *Tel / Email: + 355 68 20 95 150 , selasltd@hotmail.com*
*Tiranë-Albania*

## Disa të dhëna të përgjithshme për veprën

Zona ku do te trajtohet rehabilitimi i kanalit ushqyes për rezervuarin e Mbolanit, nga pikepamja gjeografike, perfshin pothuajse të gjithe segmentin e lugines në rrjedhen e siperme te pellgut shimbledhese të rezevuarit te Mbolanit (shih ortografine e zones).

Kanali, ose gjurma e kanalit ekzistues, eshtë relativisht më e gjatë se sa parashikohet ne projekt, por në këtë faze, parashikohet të trajtohet pothuajse vetem gjysma e kësaj gjurme, në një gjatësi prej rreth 320 ml.

Ashtu siç u shprehën edhe drejtuesit e pushtetit lokal të zonës, qëllimi kryesor i rehabilitimit të këtij segment kanali, është që të shmangë sa më mirë të jete e mundur rrjedhen e një pjese të ujit në një depresion (lugine) tjetër, që, fillimisht pothuajse nisin të rrjedhin në të njëjtin pellg, por që më tej, në përshtatje edhe me terenin vijojnë rrjedhen shpesh në pellgje të ndryshme dhe, jo ne të njëjtin pellg që do të ishte më e mira.

Praktikisht ky pellg shimbledhës, i cili për nga pozicioni topgrafik është pothuajse në një kuote me përroin ose luginën që derdhet ne krahun e djathte te rrjedhes, ndërkohë që kanali ynë duhet të orientohet për të rrjedhur majtas e të përfundoj në krye të kupës së rezervuarit.

Nga pikepamja topografike, relievi i zones ku shtrihet rezervuari dhe tokat e kultivuara, që ujiten me të, perfaqesohet nga nje zone mbi kodrinore deri edhe malore me lartesi absolute qe leviz nga 500 ÷ 600 m. mbi nivelin e detit.

Pergjithesisht, masivi i tokave qe do te ujiten nga ky rezervuar megjithese me parcelizme te vogla , është deri diku i sistemuar por aktualisht per shkak te mosfunksionimit, per nje kohe te gjate te kanalit ujites, kultivimi i ketij masivi relativisht, është shume i kufizuar dhe pothuajse, mund të konsiderohet edhe si i pashfrytezuar fare.

Duke qene nje zone fare afer qendrave te banuara, ndër kulturat bujqesore qe mbillen në këtë zonë, nje vend te rendesishem zene perimet e te gjitha llojeve, por nuk mungojne edhe drithrat, foragjeret e pemet dru-frutore si dhe vreshtat, per kultivimin e te cilave formacionet pedologjike te tokes jane me se te favorshme

*Adresa : Rruga Vaso Pasha, Nr.7/1 Tel / Email: + 355 68 20 95 150 , selasltd@hotmail.com*
*Tiranë-Albania*

**Disa të dhëna për rezervuarin e Mbolanit dhe gjendjen aktuale të kanaleve ujitës e në mënyrë të veçantë e kanalit ushqyes të rezervuarit.**

Skema e ujitjes me rezervuarin e Mbolanit te ndertuar ne këtë zone, perfaqeson ujitjen e 80-90 ha toke, duke u shtrire deri ne afersi te fshatit Sadovice.

Rezervauri i Mbolanit, është ndertuar ne vitet 1975- 1976, pothujase ne krye te lugines ne fjale dhe e dominon ujitjen e ketij masivi pothuajse 100 % me rrjedhje te lire.

Diga e rezervaurit te Mbolanit, pozicionohet përafersisht në koordinatat 40º 39` gjeresi gjeografike Jugore dhe 19º 53`, gjatesi gjeografike lindore.

Diga e rezervuarit, perfaqesohet nga nje dige klasike homogjene e ndertuar me argjilat e karierave per rreth saj. Ajo është rreth 16 m e larte, dhe ka nje gjatesi të kurores prej rreth 160 ml, e me gjeresi te kurores afro 5 m.

Aftësia ujmbajtëse e rezervuarit llogaritet të jetë rreth 250 mijë $m^3$ ujë, por aktualisht për një kohë relativisht të gjatë, rezervuari nuk është mbushur me ujë dhe në kohën e inspektimit, Maj-Qershor 2025, niveli i ujit ishte rreth 3-4 m nën kreun e kurorës së digës. Ndërkohë që madhësia e pellgut shimbledhës të rezervurait të Mbolanit është vetem rreth 53 ha.

Marrja e ujit per ujitje realizohet nepermjet nje ujeleshuesi me tubacion nen presion, që pozicionohet paksa në qëndër të digës, kurse shkarkimi i prurjeve te teperta nga rezervuari behet nepermjet nje shkarkuesi automatik siperfaqesor i pozicionuar plotesisht në bjefin e djathtë të digës.

Qysh nga ndertimi i saj diga ka qendruar dhe ka funksionuar normalisht, pa probleme e shqetesime ne lidhje me qendrueshmerine e saj apo probleme te tjera fizike për digën, por siç u tha edhe me siper, për shkak edhe të një pellgu shimbledhës, me sipërfaqe relativisht të vogël, mundësia e mbushjes me ujë të rezervuarit është gjithnjë me pikëpyetje, çka perben dhe shqetesimin kryesor per këtë dige.




*Ortofoto e Pergjithshme e Zones*

## Kushtet e përgjithshme klimaterike dhe Hidrologjia e zonës

Lugina ku është ndertuar diga e rezervuarit te Mbolanit bën pjese në nënzonën mesdhetare kodrinore jugperendimore të Shqiperise me formacione mesatarisht te depertueshme, me një bimesi relativisht të zhvilluar, por ku duket qarte se aktualisht nuk mungojne edhe vatrat e erozionit.

Lugina dallohet për nje klimë me karakteristika të theksuara mesdhetare, me ndikimin me së shumti të detit Adriatik, kryesisht me dimer relativisht te bute e te laget dhe me vere te nxehte dhe te gjate.

Ererat jane te paqendrueshme por me shume ne zonen e dimrit mbizoteron Lindje- Jug-Lindja, qe përkon edhe me drejtimin e shtrirjes se kupes se rezervuarit, kurse ne kohen e veres dominon drejtimi i eres nga Veri - Veri-Perendimi.

*Adresa : Rruga Vaso Pasha, Nr.7/1 Tiranë-Albania* *Tel / Email: + 355 68 20 95 150 , selasltd@hotmail.com*

Temperaturat mesatare vjetore te ajrit luhaten ne shifrat 13-14ºC, nderkohe qe temeperatura mesatare e janarit nuk i kalon 5 º, kurse minimumet absolute lekunden nga -3 deri - 5ºC.
Keta faktore klimaterike percaktojen edhe periudhen e vegjetacionit ne këtë zone e cila sipas studimeve te kryera fillon ne 10 diteshin e trete te muajit mars dhe vazhdon deri edhe në fund të Tetorit.

## Regjimi i rreshjeve

Pergjithesisht zona e pellgut shimbledhes te rezervuarit te Mbolanit dallohet per sasi te konsiderueshme te rreshjeve vjetore (mesatarisht rreth 1300-1500 mm shi ne vit), por ashtu si ne te gjithe nenzonen mesdhetare kodrinore te vendit tone, edhe ne këtë zone regjimi i rreshjeve është thjesht nje regjim mesdhetar me luhatje te medha te sasise se rreshjeve gjate periudhave te ndryshme te vitit.

Sasia me e madhe e shiut bie ne periudhen e dimrit dhe te vjeshtës, pra periudha Maj-Tetor (rreth 80-82 % e rreshjeve vjetore), nderkohe qe sasira me pak te ndjeshme (rreth 18 – 20 %) bien ne periudhen e veres.

Mbështetur në një seri të dhenash, nxjerrë nga **stacioni hidrometerologjik i Sinjës,** i cili është jo me shume se 10- 12 km larg kesaj lugine (ne Jug- Perendim te zones), ku sasia mesatare shumevjecare e rreshjeve rezulton **ne 1337 mm**.

Nderkohe qe nga perpunimi i te dhenave sasia mesatare e rreshjeve per periudhen Tetor – Maj, me siguri 50 % është llogaritur te jete 821 mm ne vit.

Pellgu shimbledhes i rezervuarit ka nje siperfaqe prej afro 0,55 $km^2$ dhe deri ne aksin e rezervuarit, gjatesia e shtrirjes se ketij pellgu arrin ne rreth 1.2 km me nje pjerresi mesatare deri 8-13 %.

Persa i perket rreshjeve maximale 24 oreshe dhe ato me intervale kohezgjatje me të vogel, per siguri perseritje te ndryshme, sipas te dhenave të hershme te stacionit hidrometerologjik te Sinjës, ato jane rregjistruar e rezultojne te jene si me poshte :

*Adresa : Rruga Vaso Pasha, Nr.7/1* *Tel / Email: + 355 68 20 95 150 , selasltd@hotmail.com*
*Tiranë-Albania*

| % e sigurise / Periudha | 50 | 20 | 10 | 5 | 2 | 1 |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 72 oreshe | 92 | 131 | 157 | 184 | 215 | 240 |
| 24 oreshe | 65 | 94 | 113 | 132 | 155 | 173 |
| 6 oreshe | 42 | 61 | 74 | 87 | 102 | 114 |
| 3 (oreshe ) | 34 | 49 | 59 | 70 | 85 | 93 |
| 30' (minutshe ) | 25 | 39 | 48 | 57 | 68 | 77 |

*Shenim: Sasia e rreshjeve 30` është marre nga te dhenat per stacionin hidrometerologjik te Gjirokastres*

Pergjithesisht keto te dhena hidrologjike jane konsideruar te mjaftueshme dhe jane shfrytezuar nga projekti per llogaritjet e nevojshme qe jane bere per percaktimin e parametrave kryesor teknik te rehabilitimit te kesaj vepre.

## Kushtet gjeologo – inxhinerike te zones dhe të diges e të nenobjekteve qe lidhen me te

Kushtet gjeologo-inxhinierike të zonës, për këtë vepër janë bazuar në studime të ngjashme që janë realizuar nga specialistë të shoqërisë “Selas” sh.p.k per këtë veper apo vepra të tjera të ngjashme, siç jane studimet e kryera në peridha të ndryshme si ato qe jane kryer për riparime të digës e rezervuarit të Sadovicës – *Dhjetor 2007* etj.

Perveç sa me siper nga studiuesi janë shfrytezuar edhe materiale te tjera ekzistuese arshivale te projektit te kesaj vepre, apo te projekteve te ngjashme me te dhe bazuar ne sa me siper mund te thuhet se:

Nga ana gjeologjike, zona ku është ndertuar diga e rezervuarit te Mbolanit dhe rrjeti ujites i saj është nje zone e ndertuar nga formacione flishoidale te mases se Paleogenit (Oligocen P), qe

*Adresa : Rruga Vaso Pasha, Nr.7/1* *Tel / Email: + 355 68 20 95 150 , selasltd@hotmail.com*
*Tiranë-Albania*

perfaqesohen nga alternime shtresash argjiloro-alevrolitike me nderthurje pakosh ranore me çimentim mesatar, te cilat bien me kend 10-20 grade ne drejtim te jug-lindjes. Keto formacione ndertojne kupen e rezervuarit si dhe dy shpatullat ku është vendosur diga. Pegjithesisht keto formacione jane te zhveshura ne shpatet e kodrave dhe paraqiten mjaft te perajruara dhe si te tilla ato i nenshtrohen lehtesisht procesit te erodimit.

Kurse në zonen e kanalit ushqyes takohen gjithashtu depozitimet Kuaternare (Q4) te perfaqesuara nga dhera deluviale dhe depozitime aluviale, te cillat ndeshen pergjithesisht ne rreze te kodrave dhe ne luginen e perroit. Keto depozitime kane perberje suargjilore dhe zhavore (te cilat i perkasin shtratit te perroit dhe taracave te tij.) trashesia e te cilave arin nga 1-2 m e deri 6m.

Nga vrojtimet e kryera si gjate shfrytezimit te vepres ashtu dhe tani rezulton qe ne dige nuk jane verejtur dukuri negative si shkarje, shembje, apo filtrime te cillat mund te ndikonin ne qendrueshmerine e saj. Sidoqoftë, është rasti për të sugjeruar se një vlerësim më i hollësishëm për digën e rezervuarit të Mbolanit duhet ndërmarrë për tu kryer në një të ardhme jo të largët.

*Adresa : Rruga Vaso Pasha, Nr.7/1 Tiranë-Albania* *Tel / Email: + 355 68 20 95 150 , selasltd@hotmail.com*

# PËRMBLEDHJE

Materialet e mësipërme janë një pjesë e dokumentave të tenderit për kontratën e riparimit të kanalit ushqyesit të rezervuarit të Mbolanit, Bashkia Berat.

Punimet e mësipërme janë lokalizuar në zonën e rezervuarit të Mbolanit, në njësinë administrative Sinjë, fshati Mbolan, Berat dhe shtrihen përgjithesisht mbi kupën e rezervuarit në një gjatësi prej rreth 5-600 ml, përgjatë pellgut shimbledhës të rezervuarit, deri mbi ish-depot e rezervave të shtetit, që aktualisht lidhen me rrugën kryesore të fshatit e me rrugën Nacionale Mbreshtan-Sinjë *(shih planimetrinë skematike të zonës).*

Në këtë kontrate përfshihet rehabilitimi i pjesshëm i kanalit ushqyes të rezervuarit të Mbolanit, i cili do të shërbejë për përmirësimin e mbushjes me ujë të rezervuarit. Për rehabilitimin e kanalit ushqyes, do të kryhen kryesisht punime dheu për riseskionimin e kanalit ushqyes, si dhe veshjen e kanalit ushqyes me beton M200. Gjithashtu janë parashikuar të kryhen edhe punimet për riparimin e veprave të artit ekzistuese në këtë rrjet ose ndërtimin e veprave të reja, atje ku ato janë të nevojshme.

Përveç kanalit ushqyes, dhe disa vepra arti në këtë kanal, në kontratë përfshihen të kryhen edhe disa punime për rehabilitimin (përmirësimin) e dy rrugëve ekzistuese që lidhen me rrugën kryesore të fshatit dhe që do të ndihmojnë për realizimin e punimeve.

Ndërsa përsa i perket çmimeve, janë pranuar çmimet sipas VKM Nr 618, dt. 23-04-2023. Vlerësimi i të gjitha punimeve është bërë pasi jane realizuar me pare analizat teknike të çmimeve për të gjitha zërat e veçantë të punimeve, të bazuara në normativat teknike të konsumimit të lëndëve të para për realizimin me cilësi të të gjitha punimeve te parashikuara.

Mbi bazen e këtyre çmimeve dhe konkluzioneve është bërë vlerësimi i kushtimit të të gjithë volumit të punimeve, i cili arrin në 9.2 milion lekë me TVSH.

**Në preventivin e punimeve jepen të detajuara volumet e punimeve sipas zërave.** (*Shih bashkëngjitur preventivin e punimeve dhe analizat e vecanta pa cmime.*)

*Adresa : Rruga Vaso Pasha, Nr.7/1 Tiranë-Albania* *Tel / Email: + 355 68 20 95 150 , selasltd@hotmail.com*

*Preventivi i Punimeve pa Cmime*

| Nr. | Nr. An | EMËRTIMI I PUNIMEVE | NJËSIA | SASIA | ÇMIMI (Leke) | VLERA (Leke) |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | 3-2+3-7 | Prerje bime e shkulje rrenje Fi deri 10 cm | m2 | 1140.0 | | |
| 2 | 3-3 | Prerje peme Fi deri 20 cm | cope | 52.0 | | |
| 3 | 3.44/1 + 3.101/a | Germim dheu per riseksioinimin e kanalit (80 % me makineri) | m3 | 269.4 | | |
| 4 | 3-47/1b | Mbushje e ngjeshje me dhè per riseksionim | m3 | 57.4 | | |
| 5 | 3-243/1 | Veshje e kanalit me b/arme M 200, t=20 cm | m3 | 179.7 | | |
| 6 | 3-243 | Beton arme M 200 per dhembet shuares te energjise pergjate kanalit | m3 | 44.6 | | |
| 7 | 3-288 | Hekur betoni i vjaskuar per perforcim Fi 10 mm (ne forme zgare kuadratike me dimensione 20x20cm) | ton | 5.37 | | |
| 8 | 3-333 | Perforcim bregu me gabiona 2x1x1 m | m3 | 24.00 | | |
| 9 | An 1 | Ndertim mur mbajtes (Analize per 1 ml) | ml | 12.00 | | |
| 10 | An 2 | Ndertim ure auto Hd=1.0 m, H = 0.8 m, L= 6 m (Analize per 1 cope) | cope | 1.0 | | |
| 11 | An 3 | Ndertim ure kembesore Hd= 4 m, B= 1 m (Analize per 1 cope) | cope | 2.0 | | |
| 12 | An 4 | Ndertim Kaskade ne forme shuaresi energjie ne fund te kanalit me L = 6-10 m | cope | 1.0 | | |
| 13 | An 5 | Riparim rruge (dy rruge ndihmese qe lidhin kanalin me rrugen ekzistuese per ne objekt) | cope | 1.0 | | |
| 14 | An 6 | Prishje e shkulje vepra arti te demtuara | cope | 1.0 | | |
| | | **Shuma** | | | | |
| | | Fond rezerve 5 % | | | | |
| | | **Shuma** | | | | |
| | | TVSH 20 % | | | | |
| | | **Shuma Ndertim-Montim** | | | | |

"SELAS" sh.p.k
Projekt – Menaxhim - Konsulta

*Adresa : Rruga Vaso Pasha, Nr.7/1 Tel / Email: + 355 68 20 95 150 , selasltd@hotmail.com*
*Tiranë-Albania*

*Analizat e Vecanta pa Cmime*

**1. Ndertim Mur mbajtes Tip, H 3÷ 5 m, (Analize per 1 ml)**

| Nr | Nr. An | Emertimi i punimeve | Njesia | Sasia | Cmimi | Vlefta |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | 3-59/c | Germim dheu (80 % me makineri) | m3 | 1.78 | | |
| 2 | 3-47/1b | Mbushje e ngjeshje me dhe | m3 | 0.45 | | |
| 3 | 3-243 | Beton M 200 per mure e themele | m3 | 2.82 | | |
| 4 | 3-654/1 | F. V tuba PVC Fi 60 mm per kullime | ml | 0.60 | | |
| 5 | 3-396/1 | Nenshtrese e mbushje me zhavor | m3 | 0.10 | | |
| | | **Shuma** | | | | |

**2. Ure kalimi Hd = 1.0 m, H=0.8m, L =6 m**

| Nr | Nr. An | Emertimi i punimeve | Njesia | Sasia | Cmimi | Vlefta |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | 3-59/c | Germim dheu per vepren | m3 | 14.40 | | |
| 2 | 3-47/1b | Mbushje + ngjeshje me dhe | m3 | 5.76 | | |
| 3 | 3-243 | Beton M - 200 per mure, themele, bordura | m3 | 12.90 | | |
| 4 | 3-243/1 | Beton M 200 per shtresen dhe veshje ne (H+D) | m3 | 2.74 | | |
| 5 | 3-244/1 | B/arme M - 250 soletone (140x14x100) cm | m3 | 1.41 | | |
| 6 | 3-243/1 | Beton M - 200 per mbishtrese 4-8 cm | m3 | 0.72 | | |
| 7 | 3-288 | Hekur betoni per soletone | kg | 219.89 | | |
| 8 | 3-211 | Shtrese çakulli t = 20 cm | m2 | 21.60 | | |
| | | **Shuma** | | | | |

**3. Ure kembesore Hd = 4 m, B = 1 m**

| Nr | Nr. An | Emertimi i punimeve | Njesia | Sasia | Cmimi | Vlefta |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | 3-59 c | Germim dheu per vepren | m3 | 0.70 | | |
| 2 | 3-47/1b | Mbushje + ngjeshje me dhé | m3 | 0.30 | | |
| 3 | 3-243 | Beton M - 200 per mure, themele | m3 | 0.60 | | |
| 4 | 3-244/1 | B/arme M - 250 soletone | m3 | 0.80 | | |
| 5 | 3-288 | Hekur betoni per soletone | kg | 85.25 | | |
| | | **Shuma** | | | | |

**4. Ndertim kaskada (rënie artificiale) me barazhe me gabiona per zvogelimin e gerryerjeve ne derdhje te kanalit ushqyes e te kanalit te shkarkuesit katastrofik**

| Nr | Nr. An | Emertimi i punimeve | Njesia | Sasia | Cmimi | Vlefta |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | 3-59 c | Punime dheu per nivelim e inkastrim te gabionave brenda seksionit te kanalit | m3 | 47.60 | | |

*Adresa : Rruga Vaso Pasha, Nr.7/1* *Tel / Email: + 355 68 20 95 150 , selasltd@hotmail.com*
*Tiranë-Albania*

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 2 | 3-47/1b | Mbushje e ngjeshje me dhe' | m3 | 26.54 | | |
| 3 | 2-426/3 | Thyerje e hedhje copa gure e betone ekzistues | m3 | 2.4 | | |
| 4 | 3-243 | Blloqe betoni M 200 me dimensione: (1.5 x 1 x 0.5) m | m3 | 1.5 | | |
| 5 | 3-333 | Gabiona me rrjete çeliku speciale dhe me perforcime (shih fleten e veçante te viz) | m3 | 72 | | |
| 6 | 3-288 | Hekur betoni per lidhjen e blloqeve | ton | 0.072 | | |
| | | **Shuma** | | | | |

**5. Ndertim 2 rruge aksesi per ne dige (nje rruge lidhese ne krye te kanalit dhe nje rruge ne fund te kanalit), L=410 ml**

| Nr | Nr. An | Emertimi i punimeve | Njesia | Sasia | Cmimi | Vlefta |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | 3.101/a+3.25/ b | Germim per riformatim te trasese rruges, (80 % me makineri) | m3 | 245.3 9 | | |
| 2 | 3-47/1b | Mbushje e ngjeshje (ne zona te veçanta) per trasene e rruges | m3 | 49.1 | | |
| 4 | 3-209 | Ndertim shtrese cakelli e mbeturina kave (gurore), me makineri t=10 cm | m2 | 1224. 0 | | |
| 5 | 3-212/b | Shtrese stabilizanti t= 10 cm granil + 10 % argjil, perfshi edhe bankinen nga nje ane =0.5m | m2 | 1428. 0 | | |
| | | **Shuma** | | | | |

**6. Prishje vepra ekzistuese te demtuara**

| Nr | Nr. An | Emertimi i punimeve | Njesia | Sasia | Cmimi | Vlefta |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | 3-59 /b | Germim dheu per vepren | $m^3$ | 3.5 | | |
| 2 | 2-426/5 | Thyerje + hedhje copa gure e beton | $m^3$ | 0.8 | | |
| 3 | An | Nxjerrje + heqje tuba | ml | 5.0 | | |
| | | **Shuma** | | | | |

**Për shoqërine "SELAS" sh.p.k.:**

**Ing. Vladimir Agalliu**

**Ing. Mikaela Çela**

**PREVENTIV PUNIMESH**
**MOBILIM I PARKUT CLIRIM- RAJONI NR 1**

| NR. | KODI | EMËRTIMI I PUNIMEVE. | NJËSIA | SASIA | ÇMIMI PA TVSH | VLEFTA PA TVSH |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | 1. Punime prishje | | | | |
| 1 | 3.7 | Pastrimi i gjithe zones ku shtrihen punimet nga bimesia dhe materialet e papershtatshme ,shkulje shkurre ekzistuese | m2 | 600 | 119 | 71640 |
| 2 | 2.294/1 | Heqje pllakash ekzistuese te lapidari | m2 | 50 | 551.63 | 27581.5 |
| 3 | an | Cmontim i stolave ekzistuese | cope | 10 | 500 | 5000 |
| 4 | 2.37/1a | Transport materiale ndertim, dheu me auto deri 1.0 km | m3 | 1 | 106.2 | 106.2 |
| | | SHUMA 1: | | | | **104,328** |
| 2. PUNIME NE LAPIDARIN E LULISHTES | | | | | | |
| 1 | 2.267a | Veshje lapidari me mermer | m2 | 60 | 6,494.08 | 389644.8 |
| | 2.451 | Lyerje me hidromat, 2 duar | m2 | 50 | 344.4 | 17220 |
| | | SHUMA 2: | | | | **406,865** |
| | | 3. Mobilimi urban | | | | |
| 1 | an | FV Stolash | cope | 10 | 20000 | 200,000 |
| 2 | an | FV kosh metalik | cope | 10 | 10000 | 100,000 |
| | | SHUMA 3: | | | | **300,000** |
| 4. Punime per Gjelberim | | | | | | |
| 1 | 2.19 | Perpunim I siperfaqes qe do te mbillet | m2 | 400 | 955.2 | 382080 |
| 2 | 3.643/c | Furnizim dhe shperndarje plehu organik 0.5kg/m2 | m2 | 400 | 499.46 | 199784 |
| 3 | 3.643 | Mbjellje bari (gjelberim) | m2 | 400 | 163.44 | 65376 |
| | | SHUMA 4: | | | | **647,240** |
| 4. Punime per Riparimin e Ndricuesve | | | | | | |
| 1 | 2.469 | Riparim Ndricues te jashtem | cope | 10 | 1,100.00 | 11,000 |
| | | **SHUMA 5:** | | | | **11,000** |
| **Shuma Analiza pa tvsh** | | | | | | **1,469,433** |
| **Fondi Rezervë (1.0%)** | | | | | | **14,694** |
| **Shuma Analiza + Fondi Rezervë (5.0%)** | | | | | | **1,484,126.83** |
| **Shuma TVSH (20%)** | | | | | | **296,825.37** |
| **Shuma me TVSH** | | | | | | **1,780,952.19** |
| **Totali** | | | | | | |

Punoi:Ing Valentina Karabina

**MIRATOHET**
**KRYETARI I BASHKISE**
**Z. Ervin CECA**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT

Berat, më___.____.2026

RELACION

PËR MIRATIMIN E PROJEKTIT SOILSTICE-FORCIMI I INSTITUCIONEVE DHE LOKALITETEVE TONA PËR TRANSFORMIMIN E TOKËS,PËRFSHIRJA DHE ANGAZHIMI QYTETAR.

Të nderuar Këshilltarë!

Bashkia Berat është përfituese e projektit SOILSTICE, Forcimi i Institucioneve dhe Lokaliteteve tona për Transformimin e Tokës, Përfshirja dhe Angazhimi Qytetar. Ky projekt financohet nga Bashkimi Europian nëpërmjet programit HORIZON- MISS-2025-05.

Projekti SOILSTICE synon të përmirësojë shëndetin e tokës në Evropë përmes përfshirjes aktive të bashkive, fermerëve, institucioneve, organizatave dhe qytetarëve në planifikimin dhe menaxhimin e qëndrueshëm të territorit.

Në kuadër të projektit do të zhvillohen Marrëveshje Territoriale të Menaxhimit të Tokës (Territorial Management Agreements – TMAs), të cilat do të krijohen në bashkëpunim me komunitetin dhe do të përfshijnë tregues të matshëm për monitorimin e cilësisë së tokës. Projekti synon gjithashtu rritjen e ndërgjegjësimitdhe përfshirjen e qytetarëve, forcimin e kapaciteteve të administratës vendore dhe krijimin e mekanizmave afatgjatë për mbrojtjen e tokës

Në kuadër të këtij projekti, Bashkia do të përfitoje
1. 55.000 Euro e konvertuar me kursin e dates 15.07.2025 në 5,131,500 Lekë, financim nga Programi Horizon Europe për zbatimin e aktiviteteve të projektit.

2. Forcim të kapaciteteve të stafit bashkiak në planifikimin dhe menaxhimin e qëndrueshëm të tokës.

3. Mbështetje për hartimin dhe zbatimin e një Marrëveshjeje Territoriale të Menaxhimit të Tokës, me pjesëmarrjen e fermerëve, institucioneve dhe komunitetit lokal.

4. Trajnime për administratën vendore, aktorët lokalë dhe lehtësuesit në fushën e qeverisjes së tokës dhe proceseve pjesëmarrëse.

5. Përdorimin e metodologjive dhe platformave evropiane për monitorimin e treguesve të shëndetit të tokës.

6. Shkëmbim përvojash me 35 partnerë nga 11 shtete evropiane, duke përfituar nga praktikat më të mira të menaxhimit të tokës.

7. Rritje të mundësive për tërheqjen e fondeve të tjera evropiane në të ardhmen për projekte të lidhura me zhvillimin rural, mjedisin dhe klimën.

8. Përmirësim të politikave vendore për mbrojtjen e tokës, biodiversitetin dhe zhvillimin e qëndrueshëm.

Ky projekt do të zgjasë 38 Muaj deri në 31 Tetor 2029, vlera totale e projektit për Bashkinë Berat është 55.000 Euro e konvertuar me kursin e dates 15.07.2025 në 5,131,500 Lekë nga të cilat 5,131,500 Lekë janë financim i Bashkimit Evropian .Bashkia Berat nuk do të bashkëfinancojë në këtë projekt.

Faleminderit,

KRYETARI I BASHKISË
Ervin CECA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA BERAT**
**DREJTORIA E MBROJTJES CIVILE, PRONAVE, TRANSPORTIT DHE MJEDISIT**

# R E L A C I O N

**MBI MIRATIMIN E DHËNIES ME QIRA NË FAVOR TË SHOQËRISË SHELL UPSTREAM ALBANIA B.V TË PASURIVE NË PRONËSI TË BASHKISË BERAT**

**Të nderuar Këshilltarë !**

Bashkia Berat, nisur nga kërkesa nr.145 prot., datë 24.04.2026 e Shoqërisë Shell Upstream Albania B.V, për marrjen me qira të disa pasurive të paluajtshme, paraqet këtë relacion "Për nisjen e procedurave të Qirasë të disa pasurive në pronësi dhe/ose përdorim të Bashkisë Berat në favor të Shell Upstream Albania B.V.

Shell Upstream Albania B.V. (SUA) në përputhje me Kontratën e Ndarjes së Prodhimit (KNP) të Bllokut 2-3 Shqipëri në tokë në këtë kuadër të zhvillimit të mëtejshëm planifikon aktivitete operacionale të projektit në rajonin e Beratit, pranë Njësisë Administrative Sinjë të Bashkisë Berat.

Nga verifikimet e kryera në terren nga specialistet Shell Upstream Albania B.V, rezulton se preket disa pasuri të paluajtshme në pronësi dhe/ose përdorim të Bashkisë Berat, e llojit kullotë me sipërfaqe prej 20,226 (njëzetëmijë e dyqind e njëzetë e gjashtë) m², me ZK 1687 me nr. pasurie 52, e llojit kullotë me sipërfaqe prej 264 (dyqind e gjashtëdhjetë e katër) m², me ZK 1687 me nr. pasurie 50/36, e llojit kullotë me sipërfaqe prej 5,034 (pesëmijë e tridhjetë e katër) m², me ZK 1687 me nr. pasurie 21/6, e llojit kullotë me sipërfaqe prej 414 (katërqind e katërmbëdhjetë) m², me ZK 2634 me nr. pasurie 259, evidentuar në listën bashkëlidhur projektvendimit, për të cilën, për nevoja të projektit, Investitori i Projektit kërkon të marrë me qira për një periudhë 1 vjeçare me të drejtë rinovimi çdo vit, nëpërmjet nënshkrimit të kontratës së Qirasë.

Kjo kërkesë mbështetet në Ligjin 139/2015 "Për vetqeverisjen vendore" Neni 8 pika 1.2 "Të drejtat dhe përgjegjësitë" nënpika "a" dhe "c" si dhe VKM nr 433 datë 8.6.2016 "Për transferimin në pronësi të Bashkive të pyjeve dhe kullotave publike sipas listave të inventarit, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish - Komunave/Bashkive, pika 4 si dhe të VKM Nr 1064 datë 22.12.2020 "Për disa ndryshime në VKM Nr 391 datë 21.6.2006 të Këshillit të Ministrave për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave" Shtojca 9 si dhe VKM nr 834 datë 21.11.2012 "Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtëshme publike shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Berat, të Qarkut të Beratit" si dhe Ligjit Nr 24 datë 9.3.2017 "Për administrimin e ujitjes dhe kullimit" si dhe VKM Nr 54 datë 5.2.2014 "Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore" Kreu III pika 2.

Bashkëlidhur do të gjeni listën e pasurive që preken nga gjurma e projektit të Shoqërisë Shell Upstream Albania B.V që kërkon ti marrë me qira për një periudhë një vjeçare me të drejtë rinovimi dhe kopje të kartelave për të katër pasuritë.
Për sa më sipër, kërkojmë nga Ju miratimin e dhënies më qira të listës së pasurive në pronësi të Bashkisë Berat në favor të Shell Upstream Albania B.V.

| Nr | Fshati | ZK | Nr. Pas | Vol | Fq | Lloji | Sip qe merret me qera($m^2$) | Çmimi i qerase lek/$m^2$ | Vlera e qerase lek/vit |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Galinë | 1687 | 52 | | | Kullote | 20226 | 128 | 2,588,928 |
| 2 | Galinë | 1687 | 50/36 | 1 | 211 | Kullote | 264 | 128 | 33,792 |
| 3 | Galinë | 1687 | 21/6 | 1 | 106 | Kullote | 5034 | 128 | 644,352 |
| 4 | Mbreshtan | 2634 | 259 | 6 | 166 | Kullote | 414 | 128 | 52,992 |

**DREJTOR I MBROJTJES CIVILE, PRONAVE, TRANSPORTIT DHE MJEDISIT**

**Sokol Toska**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA BERAT**

**DREJTORIA E MBROJTJES CIVILE, PRONAVE, TRANSPORTIT DHE MJEDISIT**

# RELACION

**MBI MIRATIMIN E TRANSFERIMIT TË PASURISË ME NR.14/337, ZONA KADASTRALE 8502, ME SIPËRFAQJE TOTALE 1443.5 M$^2$ NGA TË CILAT 1443.5 M$^2$ TRUALL DHE 751 M$^2$ NDËRTESË NGA BASHKIA BERAT TE KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR (KLGJ) PËR NDËRTIMIN E GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM BERAT.**

**Të nderuar Këshilltare !**

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", të ndryshuar, si dhe legjislacionit në fuqi për administrimin e pronave publike, paraqitet për shqyrtim dhe miratim në Këshillin Bashkiak Berat propozimi për transferimin në pronësi të Këshillit të Lartë Gjyqësor (KLGJ) të pasurisë nr.14/337, zona kadastrale 8502, me sipërfaqje totale 1443.5 m$^2$ nga të cilat 1443.5 m$^2$ truall dhe 751 m$^2$ ndërtesë, pronë e Bashkisë Berat ku aktualisht është në funksion si magazinë e Drejtorisë së Arsimit të Bashkisë.

Ky propozim mbështetet në kërkesën zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor me shkresën nr.975 prot., datë 04.05.2026, si dhe në konkluzionet e takimit institucional të zhvilluar në ambientet e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, ku morën pjesë përfaqësues të KLGJ-së, Ministrisë së Mbrojtjes, Ministrisë së Shtetit për Pushtetin Vendor, Bashkisë Berat dhe përfaqësues të Gjykatës.

Në diskutimet e kryera ndërmjet institucioneve u theksua nga përfaqësuesit e gjykatës se godina aktuale e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat nuk plotëson standardet e nevojshme infrastrukturore, funksionale dhe të sigurisë për ushtrimin normal të aktivitetit gjyqësor. Ambientet ekzistuese janë të kufizuara dhe të pamjaftueshme për numrin aktual të gjyqtarëve, administratës dhe qytetarëve që marrin shërbime pranë këtij institucioni. Janë evidentuar gjithashtu problematika të rëndësishme që lidhen me mungesën e hapësirave funksionale për zhvillimin normal të seancave gjyqësore, si dhe me mungesën e hyrjeve dhe ambienteve të posaçme që garantojnë sigurinë e gjyqtarëve dhe administratës. Po ashtu, godina ekzistuese paraqet pamundësi teknike për zgjerim apo rikonstruksion, ndërsa mungesa e kushteve bashkëkohore vështirëson aksesin dhe administrimin eficient të proceseve gjyqësore.

Në kuadër të zgjidhjes së kësaj situate dhe garantimit të standardeve të kërkuara për funksionimin e sistemit gjyqësor, është vlerësuar si zgjidhje më të përshtatshme ndërtimin e një godine të re për Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat.

Për këtë qëllim është propozuar përdorimi i pasurisë nr. 14/337, zona kadastrale 8502, me sipërfaqe totale 1443.5 m$^2$, në lagjjen "30 Vjetori", e pozicionuar në një zonë të përshtatshme urbane dhe me akses funksional për realizimin e këtij investimi publik me rëndësi të veçantë institucionale dhe qytetare.

Pasuria në fjalë rezulton në pronësi të Bashkisë Berat dhe konsiderohet e përshtatshme për realizimin e projektit, duke marrë në konsideratë pozicionin e saj, mundësinë për zhvillimin e infrastrukturës gjyqësore sipas standardeve bashkëkohore, krijimin e kushteve të nevojshme të sigurisë dhe funksionalitetit për institucionin e gjykatës, si dhe interesin publik që lidhet me përmirësimin e aksesit të qytetarëve në sistemin e drejtësisë.

Transferimi i kësaj pasurie në pronësi të Këshillit të Lartë Gjyqësor nuk ndryshon pronësinë publike të saj, por realizohet me qëllim përdorimin funksional dhe institucional të pasurisë për ndërtimin e godinës së re të gjykatës, në funksion të ushtrimit të kompetencave kushtetuese dhe ligjore të sistemit gjyqësor. Realizimi i këtij projekti pritet të sjellë përmirësim të kushteve të punës për gjyqtarët dhe administratën, rritje të standardeve të sigurisë, përmirësim të shërbimeve ndaj qytetarëve, modernizim të infrastrukturës gjyqësore në qytetin e Beratit, si dhe krijimin e ambienteve të përshtatshme sipas standardeve të kërkuara nga sistemi i drejtësisë.

Për sa më sipër, vlerësohet i nevojshëm miratimi nga Këshilli Bashkiak Berat i transferimit në pronësi të Këshillit të Lartë Gjyqësor të pasurisë nr. 14/337, zona kadastrale 8502, me qëllim realizimin e projektit për ndërtimin e godinës së re të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat me kushtin që objekti ekzistues i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat me nr.5/124 pasurie, ZK 8503, të transferohet në pronësi të Bashkisë Berat, me qëllim përdorimin për kryerjen e funksioneve të saj.

**DREJTOR I MBROJTJES CIVILE, PRONAVE, TRANSPORTIT DHE MJEDISIT**

**Sokol Toska**